

## Skenderbeu/ Abazi do te mungoje per gjashte muaj

nga AlbaniaSoccer  
E martë, 08 Tetor 2013 20:40

---



Skenderbeu ka marre nje lajm te keq per mesfushorin e talentuar nga Kosova Leonit Abazi. Pas vizitave te specializuara ne Maqedoni, lojtari i kampioneve ka mesuar se demtimi i tij ne gju eshte me i rende nga cfare ai dhe treneri Mirel Josa kishin shpresuar. Abazi do te operoje ligamentin e demtuar gjate ketij muaji ne Tirane dhe me pas do te mungoj per gjashte muaj. Rikthimi tij ne fushe pritet te vij ne fund te sezonit dhe per Skenderbeun mungesa e tij do te jete e rendesishme. Abazi u bashkua ne vere me kampionet e vendit dhe luajti ne disa takime duke treguar cilesi mjaft te mira.